



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë nenin 22 paragrafi 1 në lidhje me nenin 45 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/20219) dhe nenin 40 paragrafi 4 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në seancën e 46 të mbajtur me datë 12.02.2021, KSHPK morri

VENDIM

Në përputhje me nenin 114 paragrafi 3 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave të ngritet procedure për barazim duke dhënë urdhër-pagesë kundër personi zyrtar të RMV, sepse si pronarë i shoqërisë aksionare SHPTSH, me çka është vepruar në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe dënuar në përputhje me nenin 105 paragrafi 1 alinea 2 nga ligji i njëjtë.

SQARIM

Lënda me numër 09-949/1 me datë 01.03.2021 është formuar me vet-iniciativë në lidhje me kontrollimin e rregullt të Formularit – Deklaratës për interesa të dorëzuar nga RMV, përshkak se si pronarë k amenaxhuar me shoqërinë aksionare SHPTSH, gjë që është në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Në përputhje me nenin e përmendur:

- (1) *Personi i cili merr funksion me zgjedhje ose emërim, me përjashtim të personave të cilët marrin funksion i cili nuk ekzekutohet profesionalisht, nëse menaxhon me shoqëri aksionare ose institucion si pronarë, është i obliguar që parase të merr funksionin menaxhimin duhet t'ia beson personi tjetër ose trupi, përveç anëtarëve të familjes së vet, gjatë kohës derisa kryen funksionin, autorizimet publike ose obligimet.*

Personit me Vendim për verifikim të mandatit të në Republikës e Maqedonisë së Veriut nr. 08-2362/1 me datë 04.08.2020 i është verifikuar mandati për në Republikën e Maqedonisës së Veriut. Pas kontrollimi në Sistemin distributes të Regjistrimit qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me datë 12.02.2021 është vërtetuar se personi i përmendur është menaxhues i shoqërinë aksionare SHPTSH

Në bazë të kësaj gjendje faktike të caktuar, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në seancën e mbajtur me datë 12.02.2021, vendosi sipas dispozitave.

Në bazë të nenin 114 paragrafi 3 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror personit të emëruar i ka shqiptuar dhe i ka dorëzuar urdhër-pagesë për shkelje të nenin 45 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, dënuar sipas nenit 105 paragrafi 1 alinea 2 nga ligji i njëjtë.

КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОР ПЃР
PARANDALIM ТЃ КОРРУПСИОНИТ
Kryetarё: Biljana Ivanovska

Pas pёrfundimit тё KSHPK
Pёrpunoi: S. M., bashkёpuntor i lartё

